



|                                        |           |
|----------------------------------------|-----------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO |           |
| KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRAN   |           |
| 01 Nr. / Br                            | 137/22    |
| Nr. i fq. / Br. st                     | - 6 -     |
| Data: / Datumi                         | 16.6.2022 |
| VENDITIMI - VËRTETIMI                  |           |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRAN

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12 maj 2022 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 11:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Ilmi Azemi, Lorik Maxhuni, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese e KK dhe KPF-së)

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Shpëtim Zhegrova, (Nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive, Ismet Gashi, nga zyra ligjore, Haki Maloku, nga zyra e kryetarit, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.*

Në mungesë të kryesueses, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Ilmi Azemi (anëtari më i vjetër i KPF-së), i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Azemi tha se kemi edhe pika shtesë, të cilat na kanë ardhur për t'i shqyrtuar.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkryetar i komunës** – kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës <Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren buxhetore 2022 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjimet publike>, pasi që nuk ka ardhur ende Qarkorja nga Ministria e Financave. Nëse vjen nga ministria, atëherë do ta përcjellim në kuvend si pikë të rregullt.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

### R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.4.2022;
2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve;
3. Shqyrtimi i raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe caktimin e kufijve të lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Peticionit i përbashkët i banorëve të sheshit “Adem Jashari” dhe rrugës “Galip Badivuku” për largimin e trafos së rrymës nga sheshi.
8. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.4.2022.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 13.4.2022.***

2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – theksoi se materiali na është dërguar me vonesë (vetëm dje na ka ardhur në e – mail). Kurse, në material mungojnë propozimet për dy çmimet më të rëndësishme që i ndan kuvendi komunal me rastin e Ditës së Çlirimit: “Nderi i qytetit” dhe “Qytetar nderi”. Prandaj, ai kërkoi sqarim se pse nuk janë sjellur këto propozime, si dhe propozimet për mirënjohje pse kanë ardhur me vonesë.

Pa dashur ta kontestojë listën e të propozuarve për mirënjohje, kishte me qenë e rrugës të na shpjegohet forma se si janë propozuar, sepse sa e shoh nuk është gjithpërfshirëse, ku mungojnë propozimet nga fushat e ndryshme. Me keqardhje e them, por po shihet që lista është e ngarkuar me ngjyime politike. S’po di kryetari i komunës a e ka shumë shok dhe janë të lidhur emocionalisht, apo i kanë borxh, Habib Mustafës, ku në seancat e mëhershme e propozuan edhe anëtarë të KKS-së, tani e keni propozuar edhe për mirënjohje. Prandaj, të paktën për këtë ditë është dashur të liroheni nga ngarkesat politike. Kishte me qenë mirë që edhe grupet kuvendare të përfshiheshin në dhënien e propozimeve dhe të kishte konsulta paraprake, e jo pastaj të vjen puna në kuvend të dalin edhe propozime tjera e t’i fusim pastaj në garë.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – lidhur me emrin që e apostrofoi kolegu, unë në mënyrë kolegjiale dua të sqaroj se Habib Mustafa është ndër emblemat më të shkëlqyeshmë të pjesës së Çyçavicës, lidhur me kontributin e tij në UÇK, pastaj është veteran i arsimit, po ashtu anëtar i kuvendit për disa mandate, një mandat ka qenë edhe kryesues i kuvendit. Prandaj, edhe kuvendi dhe qyteti nderohen me ndarjen e mirënjohjes për këtë personalitet. E pashe emrin e Enver Dubovcit në listën e të propozuarve, i cili ka qenë i propozuar edhe në mandatet e kaluara dhe nuk e ka përkrahur as komiteti e as kuvendi. Prapë, ka hyrë në listë me propozim të komisionit. Në atë kohë, edhe pse nuk ka fituar Enver Dubovci, drejtoresha e kulturës Shpresa Rama i ka ndarë mirënjohje në mënyrë zyrtare. Prandaj, nuk mund të merret dy herë mirënjohje.

Konsideroj se kjo listë e propozimeve duhet të plotësohet dhe ndryshohet.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkryetar i komunës** – tha se lidhur me çështjet që i ngriti Sylejmani lidhur me çmimet: “Nderi i qytetit” dhe “Qytetar nderi”, sigurisht që jemi konsultuar dhe me material të kuvendit ose gjatë seancës, kryetari i komunës do t’i bëjë propozimet. Sa i përket vonesës së materialit është çështje e komisionit dhe nuk e dimë pse janë vonuar, sigurisht për shkak të biografive. Lidhur me mirënjohjet, edhe unë kam propozuar që t’iu jepet hapësirë anëtarëve të kuvendit për të japë propozimet e tyre. Nëse ka më shumë se 10 propozime, atëherë me votim të fshehtë bëhet përzgjedhja.

Ndërkaq, lidhur me Habib Mustafën, unë konsideroj se është vonë që po i jepet kjo mirënjohje, sepse e përmendi edhe Ilmiu kontributin e tij dhe nuk më takon ta ripërsëris. Mendoj që është titull i vogël që i jepet për kontributin që ka dhënë ai deri sot për vendin.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – deklaroi se nuk po e konteston kontributin e askujt. Por, edhe në mandatin e kaluar jemi munduar që secili të dalim përtej ngjyimeve politike për ta nderuar dikë. Por, po kërkoj që të ketë këso refleksione edhe për juve si qeverisje dhe ta vazhdojmë një traditë të mirë.

Në qoftë se ka një figurë qyteti, i cili ka dhënë 20 vite kontribut, është edhe i ndjeri Fadil Muzaqi, që ka qenë bashkëpartiak i juaji dhe dihet kontributi i tij në fushën e prokurimit. Nuk ka projekt që për 20 vite nuk ka kaluar nëpër duart e tij me angazhimin që e ka bërë në administratën komunale. Prandaj, unë jam për t'i nderuar personat që kanë kontribuar.

**Medina Bunjaku, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – deklaroi se komisioni në përbërje: unë si kryesuese, Ergin Sunguri, Benjamin Shala, Shaip Hyseni dhe Ujmir Uka (anëtarë), pas tri mbledhjeve të rregullta që i kemi mbajtur, i kemi rishikuar listat e personaliteteve që janë nderuar me mirënjohje që nga viti 2002 – 2021. Pasi që është një numër i madh i mirënjohjeve që janë ndarë, si dhe tërheqja e Enver Dubovcit nga kjo listë, para jush keni 8 emra të propozuar për mirënjohje. Kurse, për çmimet “Nderi i qytetit” dhe “Qytetar nderi”, pas konsultimit me kryetarin e komunës, propozimet do të dërgohen për kuvend. Ajo sqaroi edhe për Habib Mustafën që është historian e jo mjek (gabim teknik në biografi). Kurse, biografia e tij nuk është bërë nga ana jonë, por nga familjarët e tij.

Për shkak se ka qenë kohë e shkurtër që ka punuar komisioni, edhe materiali ka ardhur me vonësë. Ajo deklaroi se komisioni nuk ka punuar mbi bazën e ngjyimeve politike që u ngrit këtu si shqetësim. Kurse, i mirëpresim edhe propozimet nga ana e anëtarëve të kuvendit.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – kërkoi që të procedohet në kuvend, pastaj atje ta plotësojmë me propozime tjera.

**Ismet Gashi, nga Zyra Ligjore** – i sugjeroi komisionit që për kuvend le të përgatitet në formë të propozim – vendimit, e jo si listë për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të përgatitet në formë të propozim – vendimit dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

### 3. Shqyrtimi i raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

**Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – sqaroi se kjo pikë është e cila është kthyer nga kuvendi dhe janë përmirësuar të gjitha mangësitë teknike që kanë qenë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – kërkoi sqarime lidhur me disa kode buxhetore, psh: shpenzimet për internet janë rritur, në vitin 2021 kanë qenë 799.90€, kurse tani janë 1818.25€. Pastaj, kodi 13509 <pajisje tjera më pak se 1000 euro>, vitin 2021 ka pasur zero euro, kurse tani kemi 11,241.00€. Kodi 13720 <naftë për ngrohje qendrore>, në vitin 2021 janë shpenzuar 5,329.40€, kurse në vitin 2022 janë shpenzuar 18,006.16€. Është evidente që është shtrenjtuar çmimi i naftës, por këto shifra janë katërfish më shumë. <Avans për udhëtime zyrtare>, në vitin 2021 janë shpenzuar 800.00€, kurse në vitin 2022 për periudhën e njëjtë janë shpenzuar 3,139.00€. <Regjistrimi i automjeteve> në vitin 2021 janë shpenzuar 430.00€, kurse në vitin 2022 për periudhën e njëjtë janë shpenzuar 2,101.85€. A janë blerë vetura të reja, apo çfarë ka ndodhur, apo i ka lënë qeverisja paraprake pa regjistruar?

<Mirëmbajtja e teknologjistikë informative> në vitin 2021 janë shpenzuar 454.95€, kurse në vitin 2022 për periudhën e njëjtë janë shpenzuar 1,575.01€.

Këto janë vetëm disa prej atyre diferencave të mëdha, për të cilat kërkojmë sqarim se çfarë ka ndodhur.

**Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – deklaroi se të gjitha këto shqetësime që i paraqiti parafolësi, mund t’ia përcjelli me e-mail, për secilën veç e veç dhe me fatura, pasi që janë materiale voluminoze.

***Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.***

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – kërkoi sqarim se këto parcela që janë planifikuar për t’u dhënë në shfrytëzim, a kanë qenë të shfrytëzuara më parë dhe a ju ka skaduar afati i kontratës? Kemi pasur disa raste kur kemi thirrur seancë të jashtëzakonshme me pika jo aq të jashtëzakonshme. Prandaj, më e rëndësishme do të ishte sikur të thirrej seancë e jashtëzakonshme dhe të diskutohet si kjo pikë e rendit të ditës dhe të diskutohet më gjerësisht. E kemi këtë muaj një seancë të kuvendit të ngarkuar dhe nuk e di sa mundemi ta trajtojmë sa duhet këtë çështje, sepse bëhet fjalë për disa prona. Nuk jemi kundër që ta procedojmë në kuvend, por si pikë e rendit të ditës do ta ngarkojë shumë seancën e kuvendit me diskutim. Nuk e di a ka qenë praktikë e mëhershme, por me vendos për kaq shumë prona në pako, konsideroj që është ngarkesë e madhe dhe përgjegjësi për anëtarët e kuvendit që do të votojnë dhe për qeverisjen që po pretendon t’i japë në shfrytëzim kaq shumë prona me një sipërfaqe të madhe.

**Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** – sa i përket propozim – vendimit në fjalë nuk ka vend për shqetësim, sepse nuk po ipen në shfrytëzim, por planifikohen për t’u dhënë në shfrytëzim. Është një obligim ligjor në bazë të nenit 13 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme për publikimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës. Këto prona që planifikohen të ipen në shfrytëzim janë të lira si “zogu” dhe të njëjtat i kemi konfirmuar dhe kemi komunikuar me palë (personat e interesuar). Sipas ligjit, nuk ka komision me mandat, por komisioni formohet ad hoc për secilën pronë që ipet në shfrytëzim.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – tha se nuk mund të konstatojmë me siguri të plotë se ndonjëra nga pronat nuk është duke u shfrytëzuar, sepse nga përvoja që kemi pasur kur është dhënë në shfrytëzim prona për fabrikë të peshkut (edhe pse nuk u bë), një pjesë e asaj parcele ishte duke u shfrytëzuar, po ashtu edhe te Zona Ekonomike në Lumadh kanë qenë disa parcela duke u shfrytëzuar me apo pa leje. Prandaj, në bazë të ortofotos duket mirë, por për ta vërtetuar duhet me dalë në terren. Prandaj, uroj dhe gëzohem nëse këto prona janë të lira për shfrytëzim.

**Alban Bajrami, anëtar i KPF-së** – pyeti se ish – objekti i shkollës në Stanoc të Epërm a është e njëjta që është fabrikë e tekstilit?

**Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** – po është e njëjta.

**Alban Bajrami, anëtar i KPF-së** – por ti drejtor the që nuk janë duke u shfrytëzuar.

**Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** – e kam cekur për atë pronë që është me procedurë të negocimit. Ne për këtë pronë kemi komunikuar me AKP-në dhe ata kanë thënë që nuk është pronë e jona. Pra, e vetmja parcelë që nuk ka certifikatë të

pronës dhe kopje të planit është pikërisht kjo në Stanoc të Epërm. Këto prona janë propozim për t'u dhënë në shfrytëzim, kurse ju keni të drejtë ta hiqni cilëndo pronë që e vlerësoni se nuk i plotëson standardet.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – drejtor ti po i referohesh nenit 13 që është obligim ligjor për me e publikuar listën, kurse në propozim – vendim jeni thirrur në nenin 14, pika 1, a mos është ndonjë gabim?

**Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** – tash po e shoh që juristi kur e ka hartuar këtë propozim – vendim e paska gabuar, por për kuvend do ta përmirësojmë.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrisë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe caktimin e kufijve të lagjeve urbane të Komunës së Vushtrisë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

7. Shqyrtimi i Peticionit i përbashkët i banorëve të sheshit “Adem Jashari” dhe rrugës “Galip Badivuku” për largimin e trafos së rrymës nga sheshi.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – e pashë këtë peticion dhe e di se për çfarë bëhet fjalë, sepse edhe sa kam qenë drejtor në Drejtorinë për Inspektime kam hasur në probleme me atë trafo, ku ka pasur shumë shqetësime nga ana e banorëve për rrezikimin e Qytetarve. Prandaj, ta procedojmë në kuvend dhe të diskutojmë për gjetjen e një zgjidhjeje, tha ai.

**Ismet Gashi, nga Zyra Ligjore** – sugjeroi që të kërkohet nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që deri në seancën e kuvendit të vjen me një rekomandim konkret për gjetjen e një zgjidhjeje.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës** – sa i përket peticioneve, e dimë që është obligim ligjor që të shqyrtohen në kuvend dhe t'iu kthehet përgjigje palëve. Lidhur me këtë çështje, vendosja dhe zhvendosja e trafove është në kompetencë të KEDS-it dhe fatkeqësisht që sa kohë nuk është duke iu përgjigjur institucioneve komunale. Sa jam në dijeni, projekti që ka qenë për zhvendosjen e kabllave nga sheshi, ka qenë edhe zhvendosja e kësaj trafoje. Kryetari i komunës e ka themeluar një komision, i cili na ka konstatuar se mjetet për zhvendosjen e kësaj trafoje janë paguar, kurse trafoja ka mbetur ende aty. Prandaj, i mbetet Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit që ta jep një propozim që të caktohet një lokacion për zhvendosjen e kësaj trafoje.

**Sylejman Mehल्ली, anëtar i KPF-së** – meqenëse po bëhet fjalë për një çështje që e rrezikon sigurinë e qytetarëve, pavarësisht aspektit ligjor, si kuvend kemi të drejtë të nxjerrim një rekomandim për KEDS-in si një lloj presioni publik për të bërë zgjidhje. Por, për mua është më shqetësuese atë që e tha nënkryetari që është paguar shërbimi për largimin e trafos dhe nuk është bërë zhvendosja e saj. Prandaj, komuna duhet të ushtrojë një padi kundër KEDS-it për mospërbushje të obligimeve

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, por Drejtoria për Urbanizëm ta përgatis një rekomandim për këtë çështje.*

8. Të ndryshme.

**Sylejman Mehल्ली, anëtar i KPF-së** – dua ta paraqes një shqetësim lidhur me procedurat e rekrutimit në komunë, me theks të veçantë në shëndetësi. Kryetari i komunës është zotuar për transparencë dhe llogaridhënie, për të monitoruar nga afër konkursat e rekrutimit. Prandaj, kërkoj nga Kryetari i komunës që deri në seancën e kuvendit t'i anulojë të gjitha procedurat e brendshme dhe të jashtme në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për shkak të shkeljeve ligjore që kanë ndodhur dhe aferave që janë përfolur. Komuna e Mitrovicës (që udhëhiqet nga i njëjti subjekt politik) e ka bërë një gjë të tillë, pasi që është përfolur se janë bërë shkelje të procedurave. Mos e shkatërroni atë që është ngritur në shëndetësi me mund, ku për këto konkurse po flitet shumë që ka shkelje ligjore. Nëse nuk shoh reflektim deri në kuvend, si subjekt politik do t'i paraqesim faktet për shkeljet ligjore dhe kërkojmë që të jetë prezent në seancë edhe zyra ligjore.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës** – sa i përket këtij shqetësimi, po e marr fjalën, pasi që kryetari është jashtë vendit. Çdo konkurs që shpallet, publikohet në web faqe të komunës dhe në tabelën e shpalljes dhe po besoj që ka bazë ligjore dhe është transparente. Nëse do të kishte shkelje ligjore, atëherë janë edhe filtrat tjerë që do ta kthenin në pikën zero. Nëse ke fakte dhe argumente për shkelje ligjore, t'u kisha lutur që t'i publikoni dhe adresoni çështjet aty ku duhet dhe mos e prit kuvendin hiç dhe aty ku ka shkelje ligjore do të na keni mbrapa edhe neve si qeveri komunale.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

**Bujar Klinaku**

  
Procesmbajtës

**Melihate Basholli - Latifi**

  
Kryesuese e KK-së dhe e KPF-së

